MAHLE

Pasqyrë e informacioneve dhe shërbimeve

MAHLE Aftermarket GmbH
Pragstraße 26 – 46
70376 Stuttgart/Gjermani
Telefon: +49 711 501-0

www.mahle-aftermarket.com
www.mpulse.mahle.com

mahled-094/06.2020/SQ

MAHLE Aftermarket – Gjithmonë programi i duhur

MAHLE Aftermarket bashkon shtatë marka të forta, të cilat, në rang global apo rajonal, përfaqësojnë inovacione dhe cilësi pa kompromis.

Përfitoni nga ekspertiza jonë si dhe nga gama e produkteve tona gjithëpërfshirëse dhe gjithnjë e në rritje në fushat e mëposhtme:

- Pjesë motori
- Guarnicione
- Filtra
- Sistemi i ftohjes dhe i ajrit të kondicionuar
- Motorë starter dhe gjeneratorë
- E-mobiliteti dhe elektronika
- Pajisje për ofiçina dhe diagnostikim

Nëpërmjet rrjetit gjithëpërfshirës të logjistikës, produktet tona janë shumë shpejt në dispozicionin tuaj.

Në faqet e mëposhtme ju prezantojmë ofertën tonë të gjerë të informacionit, këshillimit dhe të shërbimeve.

Portali MAHLE CustomerCare

Portali digjital i klientëve MAHLE është çelësi për botën tonë të shërbimit, sepse këtu do të gjeni të gjitha produktet, shërbimet dhe informacionet që janë të rëndësishme për punën e përditshme.

Përveç një sistemi biletash me të cilin mund t'ua drejtoni pyetjet tuaja direkt ekspertëve të MAHLE, ju keni në dispozicion edhe dyqanin tonë të materialeve të reklamimit. Të gjitha materialet që po ju paraqesim në faqet vijuese mund t'i porosisni shumë lehtë këtu.



Regjistrohuni tani pa pagesë tek
customercare.mahle-aftermarket.com

Broshurat e dëmeve

Broshurat tona të dëmeve janë tashmë një referencë e domosdoshme për ofiçinat dhe mekanikët amatorë. Me fotografi dhe shpjegime të hollësishme të dëmeve, shkaqeve dhe zgjidhjeve ose shmangien e dëmeve, ne përshkruajmë rastet e shpeshta të dëmeve në grupet përkatëse të produkteve.

Trajnime të kualifikuara

Ekspertët e produkteve MAHLE Aftermarket, me një valixhe të mbushur plot me ekspertizë, mund të vijnë tek ju, ose ju dhe stafi juaj mund të na vizitoni për një seminar të orientuar drejt praktikës. Në çdo rast, trajnimet tona të kualifikuara do t'i sjellin njohuritë tuaja teknike në stadin më aktual.

Jeni të interesuar? Atëherë thjesht pyesni partnerin tuaj tregtar ose dërgoni email në ma.training@mahle.com.

Poster teknik

Posterët teknikë ofrojnë mbështetje praktike në punën e përditshme me informacione të dobishme për çmontimin dhe montimin e produkteve tona. Gjithmonë të pranishëm dhe për këtë arsye menjëherë gati kur të keni nevojë për ta.

Technical Messenger

Informacione dhe këshilla teknike të vlefshme rreth temave aktuale të mirëmbajtjes dhe të riparimit, thjesht me anë të emailit. Technical Messenger shfaqet në faqen tonë të internetit në intervale të rregullta, dhe nëse dëshironi, ne mund t'ju informojmë me email rreth tij.

Broshurat e dëmeve dhe posterët teknikë mund t'i gjeni tek partneri juaj tregtar, direkt në dyqanin tonë të materialeve të reklamimit ose në internet në qendrën e mediave në mahle-aftermarket.com.

Dëshironi të informoheni për shpenzimet përmes postës elektronike? Regjistrohuni në mahle-aftermarket.com në rubrikën "Services".

Informacionet e katalogut

Për arsye ekologjike dëshirojmë që në të ardhmen të heqim dorë nga katalogët e printuar, por ata do të vazhdojnë të jenë në dispozicionin tuaj në formë digjitale. Në katalogun tonë online, ju gjithashtu keni akses në gamën e fundit të produkteve dhe në shumë informacione të tjera të dobishme.

Customer-Information-System (CIS), sipas dëshirës tuaj, ju ofron informacione mujore mbi lançimet e reja të planifikuara, produktet e reja dhe modelet që ndërpriten.

catalog.mahle-aftermarket.com/eu

Dëshironi të merrni buletinin informues mujor CIS?
Regjistrohuni në mahle-aftermarket.com
në rubrikën "Services".

MAHLE E-Shop

Si një tregtar me shumicë, mund të porosisni të gjitha produktet MAHLE nëpërmjet një platforme të shpejtë, të sigurt dhe të thjeshtë.

Avantazhet për ju:

- Fotot e produktit lehtësojnë identifikimin
- Disponueshmëria dhe çmimet e blerjes shfaqen menjëherë

customercare.mahle-aftermarket.com

Broshura dhe fletëpalosje

Me broshurat dhe fletëpalosjet tona ne dëshirojmë të informojmë dhe të qartësojmë ju dhe klientët tuaj si rreth kompanisë tonë, po ashtu edhe rreth produkteve dhe shërbimeve tona.

Dhe këtu ne i kushtojmë vëmendje qëndrueshmërisë ekologjike të dokumenteve tona: Ne pyesim paraprakisht për çdo porosi në shtypshkronjë, ulim tirazhin e printimeve, përdorim brenda mundësive letër të certifikuar nga PEFC, nga pyje të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme dhe mbështesim projekte për mbrojtjen e klimës me anë të teknologjisë së printimit neutral ndaj klimës.

Broshurat dhe fletëpalosjet mund t'i gjeni tek partneri juaj tregtar, direkt në dyqanin tonë të materialeve të reklamimit ose në internet në Medien Center tek mahle-aftermarket.com.

Revistë për klientë MPULSE

Revista jonë për klientët informon mbi të gjitha temat e rëndësishme rreth MAHLE dhe Aftermarket: Informacione mbi produktin dhe njohuritë në sfond, këshilla teknike për ofiçinën, udhëzime dhe video montimi, tendencat dhe zhvillimet e reja si dhe histori emocionuese dhe fushata për t'u përfshirë dhe për të fituar.



MPULSE publikohet dy herë në vit, përkatësisht në mars dhe në shtator.

MPULSE është në dispozicion gjatë gjithë vitit si revistë online tek mpulse.mahle.com.

Artikuj reklamimi

Me artikuj reklamimi tërheqës ne duam të mbetemi në kujtesën tuaj dhe të klientëve tuaj. Ne ofrojmë artikullin e duhur për të gjitha fushat e aplikimit, qofshin ato për panaire dhe evente apo ndihmës praktikë për ofiçinat.

Promovim shitjesh

Në mënyrë që t'ju mbajmë të azhornuar ju dhe klientët tuaj në lidhje me informacionet e rëndësishme të produkteve, risive dhe fushatave, ne ju vendosim në dispozicion materiale të dobishme promovimi për reklamim jashtë, në dhoma shitjeje dhe në të gjithë ambjentin e ofiçinës.

Ju mund t'i merrni artikujt promovues dhe materialet e promovimit të shitjeve tek partneri juaj tregtar ose direkt në dyqanin tonë të materialeve të reklamimit.

Kanalet e mediave sociale

Dëshironi të zbuloni çdo ditë se çfarë të reje ka dhe të merrni pjesë në fushata dhe konkurse të vazhdueshme?

Që nga informacionet mbi panairet dhe eventet aktuale, tek azhurnimet teknike dhe deri tek të rejat e përgjithshme, me kanalet tona të mediave sociale ju jeni gjithmonë të informuar.



- **mahlempulse** **në Instagram**
- **Kanali MAHLE** **në YouTube**
- **Faqja MAHLE** **në facebook**

Mbështetje individuale në shitje

Me shumë kënaqësi ne mund të hartojmë për ju koncepte individuale për t'ju mbështetur në shitje. Kontaktoni me distributorin tuaj për ofertat tona ose drejtohuni direkt tek customercare@mahle.com.

+ Panaire
+ Evente
+ Artikuj editorialë
+ Grafiqe
+ Lajmërime
+ Reklamim me banderola
+ Fushata shitjeje
+ Guida në fabrikë